



BASHKIA PRRENJAS

SPECIFIKIMET TEKNIKE

**STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION SHKOLLA STRAVAJ”**

PROJEKT ZBATIMI

SHOQERIA “ZETA KONSULT”sh.p.k
ADMINISTRATOR
LORENC HOXHA

Klauzola qe nuk aplikohen.

Çfaredo Klauzole e Specifitimeve qe lidhet me punime apo materiale qe nuk kerkohen ne Preventiv (Tabela e Volumeve) do te konsiderohet e paaplikueshme.

Kushtet atmosferike.

Do te merret si e miregjene qe Kontraktori gjate pergatitjes se ofertes se tij do te kete marre parasysh te gjitha kushtet e mundshme atmosferike ne kohen e perfundimit si dhe gjate Punimeve Permanente dhe te Perkohshme. Kontraktorit nuk i takon asnje pagese shtese si pasoje e ndodhjes, vazhdimesise apo efektit te ererave te forta, bores, acarit, shirave dhe permbytjeve, temperaturave apo lageshtires apo si pasoje e kushteve te tjera metereologjike apo hidrologjike.

Zevendesimet

Zevendesimi i materjaleve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behen vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve ne se materjali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejtë ose me i mire se materialet e specifikuara ; ose ne se materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit.Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materjaleve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

Hyrja ne sheshin e ndertimit

Sipermarresi duhet te organojo punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrale siperfaquesore te njejtë me ate qe ekzistonte perpara se Sipermarresi te hynte ne Shesh.

Programi i Punimeve dhe Punimeve te Perkohshme.

- ❖ Duke iu referuar Kontrates, programi i punimeve te Kontraktorit duhet te permboje detajet e meposhtme:
 - Radha e punimeve.
 - Ecurine e planifikuar (grafiku i punes).
 - Kapacitetet dhe llojet e impjanteve te propozuara.
 - Detajet e metodave qe do te perdoren.
 - Detajet e punimeve te perkohshme.
 - Te dhenat e detajuara mbi fuqine punetore, te kualifikuar ose jo.

Dyshemë me pllaka

Dyshemë me pllaka çimentoje ose granili me permasa 25x25 cm te ngjyrave te ndryshme, te thjeshta, duke përfshirë Shtresën me Llaç bastard te trashesise 2 cm, me dozim ne m2 : pllaka m2 1,02, Llaç bastard T-15 m3 0,02, çimento 400 kg 4, prerjen dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, n.q.s. duhet, vendosjen ngjeshur në vepër ne menyre perfekte ndermjet tyre ose te stkuara me boiake çimentoje ne fugaturat, me larjen e mepastajshme, pastrimin ne fund si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Punime Suvatimi

Suvatim i brendshëm

Sprucim i mureve dhe tavaneve, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve te muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashesi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim per m2 : rërë e lare m3 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m3 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

Suvatim i jashtëm

Sprucim i mureve per murature, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve te muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashesi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim per m2 : rërë e lare m3 0,005, Llaç bastard m3 0.03, çimento 400 kg 7.7, uje, e aplikuar, ne baze te udhezimeve te pergatitura, ne mure , dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

Suvatim i brendshëm ne rikonstrukione

Sistemim i sipërfaqeve ku eshte e nevojshme, per suvatime per nivelimet e parregullsive me ane te mbushjes me Llaç bastard me me shume shtresa dhe copa tullash n.q.s. eshte e nevojshme, edhe per zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund stukimit.

Sprucim i mureve dhe tavaneve per murature te pastruar, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve te muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashesi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim per m2 : rërë e lare m3 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m3 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

Dyer te jashtëm me xham

Furnizim në vepër dere kryesore hyrjeje me xham, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga nderrmarja ne kantier, ne dru pishe te staxhionuar ne menyre natyrale ose artificiale, i imprenjuar, e ndertuar nga : telajo e fiksuar, me seksion

6x4 cm e kompletuar me kllapa hekuri; dere me dy kanate, ku secili kanat, me skelet me seksion minimal 10x4 cm e lidhur ne fasho te ndermjetem horizontal dhe vertikal me seksion te njejtë dhe nje fasho e poshtme me lartësi 25 cm , duke formuar dy korniza nga te cilat: nje e siperme e realizuar me xham te forte me spesor mm.4 i bllokuar ne patenten e kornizes per fiksimin e xhamit me listella, mbi te cilen nga ana e jashtme do te fiksohen hekura me seksion kuadrat cm. 6,5x0,5, ne drejtimin horizontal, ne largesi nga njera tjetra cm, 23,5 dhe sipas udhezimeve te projektit dhe tjetri i poshtem i realizuar nga panele me dru pishe te staxhionuar ne menyre natyrale ose artificiale, i imprenjuar; e tera e kompletuar me te pakten dy mentesha te renda prej 16 cm për çdo kanat, me lloze mbajtes te inkorporuar ne strukturen prej druri, nje brave sigurie te madhe, e pajisur me tre celesa ,doreza alumini dhe piastrat e gojezat përkatëse me pllaka alumini, duke përfshirë punimet e muraturës, skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Zgara hekuri

8.j.1 Zgare hekuri per dritaret, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga ndermarja ne kantier, formuar nga : 3 hekura te sheshte te vendosur ne drejtim horizontal secili me permaza 3x1 cm, te ankoruar ne menyre te rregullt ne hapesiren e dritares dhe sipas udhezime te projektit; 6 hekura te rrumbullaket te vendosur ne drejtim vertikal çdo 15 cm dhe me diameter mm14.

8.j.2 Zgare hekuri i formuar nga : 3 hekura te sheshte te permasave 3x1 cm, te vendosur horizontalisht në vepër te mberthyer me bulona te pershtatshem ne telajo; hekur me diameter mm.14 i vendosur çdo 13cm, i salduar ne hekurat e sheshte te vendosur ne anen e brendshme te arkitrarit dhe ne anen e jashtme te pragut; duke përfshirë skelat e shebimit ose skelerine si dhe çdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

8.j.3 Zgare hekuri, i formuar nga: hekura te sheshte te permasave 6,5x0,5 cm , te vendosur horizontalishtë vepër dhe të ankoruar ne murature; hekur me diameter mm.14, i vendosur çdo 30 cm ; çdo gje sipas udhezimeve ne projekt, duke përfshirë çdo vepër murature, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Punime bojatise

Bojatisje me gelqere dhe boje

Stukim dhe lemid i suvasë se re me pare me stuko sintetik per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.

Nje dore solucion lidhes e formuar me rreshire te holle me 50 % uje dhe e zbatuar me penel mbi mure dhe tavane.

Bojatisje ne tre duar, me qumesht gelqereje dhe ngjyra te ndryshme per mure te brendeshem, te jashtëm dhe tavane dhe me dozature per m²: gelqere e shuar kg 0.55, pluhur ngjyre kg 0.01 si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

Njesite e betonit te parafabrikuar nuk duhet te levizen ose transportohen nga vendi i betonimit derisa te kete kaluar nje periudhe prej 28 ditesh nga data e betonimit.

Klauzolat ketu referuar betonit, hekurit te armuar dhe armatures duhet zbatuar njesoj edhe per betonin e parapergatitur.

Pllakat e betonit

Pllakat e betonit duhet te prodhohen ne fabrika te specializuara per prodhimin e tyre. Ato duhet te plotesojne nje sere kerkesash:

Dimensioni	20x10x6cm
Perdorimi	Kembesore dhe Trafik te Lehte
Pesha specifike	>2200 kg/m ³
Rezistenca ne shtypje	>500 kg/cm ²
Pershkuesheria nga uji	<12%
Ngjyra	Sipas Porosise
Sasia per m ²	50 cope

Pllakat duhet te jene te produhuara me dy shtresa

Shtresa 1 – Shtresa e Poshteme, perben 88% te volumit te pllakes dhe do jete e prodhuar ne presa me presion dhe vibrim per te garantuar Marken e Betonit dhe uniformitetin. Betoni i prodhuar duhet te jete i Klases A-A, I perqatitur me Inerte te fraksionuara me granulometri 0-8mm dhe cimento Portland e rezistueshme. Ngjyra ne kete shtrese mund te realizohet me porosi.

Shtresa 2 – Shtresa e Siperme, perben 12% te volumit te pllakes (spesorit) realizohet me inerte te fraksionuara me granulometri 0-5mm, inerte te seleksionuara kuarci me granulometri 1-3mm, oksid hekuri dhe cimento Portland e rezistueshme.

Pllakat duhet te jene te produhuara me siperfaqe te ashper (per te evituar rrreshqitjen) dhe te rezistueshme ndaj ngricave. Duhet te jene afersisht si pllakat e pasqyruar me poshte:

Mbulimi i cmimit njesi per betonet

Cmimi njesi per nje meter kub beton I derdhur mbulon furnizimin e inerteve, cimentos dhe ujit dhe perzjerjen, hedhjen dhe ngjeshjen ne cdo sektion ose trashesi, kujdesin, provat dhe te gjitha aktivitetet e tjera qe pershkruhen me siper te cilat jane domosdoshmerisht te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.

Pervec sa me siper, formimi i bashkimeve siç tregohen ne vizatimet ose siç instruktohen nga M.P., mbushja e bashkimeve me material izolues, vedosja e armimit ku te jete e nevojshme, armaturat dhe fuqia punetore Jane perfshire ne cmimin njesi te betoneve.

Vetem kosto e transportimit te inerteve, cimentos hekurit nuk perfshihen ne cmimin njesi te betonit, por ne cmimin njesi te transportit.

Matjet: Matja e volumit te betonit te derdhur do te bazohet ne permasat e marra nga vizatimet qe lidhen me kete punim.

Cdo volum betoni pertej llimiteve te treguara ne vizatime nuk do te paguhen nese M.P. nuk ka instrukuar ndryshe paraprakisht me shkrim.

Cmimet njesi per zera te ndryshm punime betoni Jane si me poshte:

Betone Kat. A&A(s) (M100, konform STASH 5112-78) Betone

Kat. B&B(s) (M200, konform STASH 5112-78) Betone Kat.

C&C(s) (M250, konform STASH 5112-78)

Betone	Kat.	D&D(s)	(M300,	konform	STASH	5112
--------	------	--------	--------	---------	-------	------

